# STATUTI
# I
# SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# "SERJANAJ STUDIO" SHPK

## KREU I
*Pjesa e përgjithshme*

Ky statut, akti i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", rregullon organizmin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK.

## KREU I
***Data e krijimit dhe Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakeve***

### NENI 1
***Data e krijimit dhe Emri***

*1.1* Sot me date 15 Korrik 2013 ne themeluesit dhe ortaket e shoqerise themelojme Shoqërine tregtare qe mban emrin **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK.
*1.2* Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

### NENI 2
***Forma***

*2.1* Shoqëria tregtare **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

### NENI 3
***Zyra Qendrore***

*3.1* Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, ne adresen Rruga At Gjeçovi Nr 3.

### NENI 4
***Objekti i Veprimtarisë***

*4.1* Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në:

a) Studio vleresimi pasurish te patundeshme
b) Projektim punimesh ndertimore.
c) Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi.
d) Punime topografike ndertimore
e) Agjensi imobiliare.

### NENI 5
***Kohëzgjatja***

*5.1* Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

**NENI 6**
***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

*6.1* Shoqëria tregtare **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**
***Përgjegjësia e Ortakut***

*7.1* Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij, që përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

**KREU II**
***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit***

**NENI 8**
***Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat***

*8.1* Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK është 10.000 (dhjetëmijë) lekë .
*8.2* Ortaket e shoqërisë kontribuojne ne kapitalin e shoqerise ne kuotat si me poshte:
a)Z. Flamur Serjanaj kontribuon dhe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 5,100 (pesemije e njeqind) leke e cila përbën 51% të kapitalit të shoqërisë.
b)Znj. Elvira Serjanaj kontribuon dhe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 4,900 (katermije e nenteqind) leke e cila përbën 49% të kapitalit të shoqërisë.
*8.3* Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaket e shoqerise Z. Flamur Serjanaj dhe Znj Elvira Serjanaj.

**NENI 9**

***Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar***

*9.1* Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te shoqerise, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
*9.2* Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te shoqerise. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

**NENI 10**

***Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar***

*10.1* Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.
*10.2* Kalimi i kuotës së kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te shoqerise ose edhe vetëm nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.
*10.3* Kuota e kapitalit mund të pjesëtohet për shkak të kalimit të saj.
*10.4* Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

# KREU III
*Organet e Shoqërisë*

## NENI 11
*Asamblea e Pergjithshme*

*11.1* Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e shoqerise.

## NENI 12
*Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme te shoqerise.*

*12.1* Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise merr vendime për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorin, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të regjistruar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotës;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- vendos për pagat e punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;
- të gjitha çështjet e tjera të cilat parashikohen në ligji dhe nuk i janë deleguar Administratorit të Shoqërisë.

## NENI 13
*Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme te Shoqerise*

*13.1* Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme te Shoqerise do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
*13.2* Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbali, regjistrohen në regjistrin e vendimeve.

## NENI 14
*Administratori*

*14.1* Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.
*14.2* Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise. Afati i emërimit të administratorit është 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje.

*14.3* Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj apo të urdhëruara me vendim të Asamblese se Përgjithshme të shoqërisë.

*14.4* Administrator i shoqërisë është ortaku Znj. Elvira Serjanaj.

**NENI 15**

***Punësimet në shoqëri***

*15.1* Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë ajo ka të drejtë të punësojë punonjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**KREU IV**

***Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve***

**NENI 16**

***Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor***

*16.1* Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
*16.2* Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqerise.
*16.3* Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

**NENI 17**

***Shpërndarja e Fitimeve***

*17.1* Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
*17.2* Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KREU V**

***Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë***

**NENI 18**

***Riorganizimi i Shoqërisë***

*18.1* Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

*18.2* Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te Shoqerise.

**NENI 19**

***Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë***

*19.1* Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te Shoqerise.

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

*19.2* Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 20**

*20.1* Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

*Ky Statut hartohet dhe firmoset në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

**ORTAKET THEMELUES**

| **FLAMUR SERJANAJ** | **ELVIRA SERJANAJ** |
| --- | --- |

# AKT THEMELIMI
# I
# SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# "SERJANAJ STUDIO" SHPK

Ortaket e shoqerise:

- **Z. Flamur Serjanaj**, shtetas shqiptar, i biri i Namikut, i date lindjes 09.04.1954 në lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartes Identitetit Nr. 024450352;
- **Znj. Elvira Serjanaj**, shtetase shqiptare, e bija e Seferit, i date lindjes 21.01.1962 në lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartes Identitetit Nr. 024449472;

bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", sot më datë 15.07.2013, hartojne këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

## NENI 1
### *Emri*

*1.1* Shoqëria tregtare mban emrin **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK.
*1.2* Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

## NENI 2
### *Forma*

*2.1* Shoqëria tregtare **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

## NENI 3
### *Zyra Qendrore*

*3.1* Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, ne adresen Rruga At Gjeçovi Nr 3.

## NENI 4
### *Objekti i Veprimtarisë*

*4.1* Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në:

- Studio vleresimi pasurish te patundeshme
- Projektim punimesh ndertimore.
- Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi.
- Punime topografike ndertimore
- Agjensi imobiliare.

## NENI 5
### *Kohëzgjatja*

*5.1* Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **"SERJANAJ STUDIO"**SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

**NENI 6**

***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

*6.1* Shoqëria tregtare **"SERJANAJ STUDIO"**SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**

***Përgjegjësia e Ortakeve***

*7.1* Ortaket nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë **"SERJANAJ STUDIO"**SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre, që përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

**NENI 8**

***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

*8.1* Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"SERJANAJ STUDIO"** SHPK është 10.000 (dhjetëmijë) lekë .
*8.2* Ortaket e shoqërisë kontribuojne ne kapitalin e shoqerise ne kuotat si me poshte:
a)Z. Flamur Serjanaj kontribuon dhe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 5,100 (pesemije e njeqind) leke e cila përbën 51% të kapitalit të shoqërisë.
b)Znj. Elvira Serjanaj kontribuon dhe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 4,900 (katermije e nenteqind) leke e cila përbën 49% të kapitalit të shoqërisë.
*8.3* Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaket e shoqerise Z. Flamur Serjanaj dhe Znj Elvira Serjanaj.

**NENI 9**

***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë **"SERJANAJ STUDIO"**Shpk janë:

- Asambleja e Përgjithshme e shoqerise
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**

***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqerise.
Afati i emërimit të adminsitratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
Administrator i parë i Shoqërisë është Znj. Elvira Serjanaj.

*Ky akt themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

**ORTAKET THEMELUES**

| **FLAMUR SERJANAJ** | **ELVIRA SERJANAJ** |
|---|---|
| Flamur Serjanaj | Elvira Serjanaj |